

VENDIM
Nr.48, datë 14.10.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli	Anëtar i	'''
Zija Vuçi	Anëtar i	'''
Hajredin Fuga	Anëtar i	'''
Franc Jakova	Anëtar i	'''
Kujtim Puto	Anëtar i	'''
Kristofor Peçi	Anëtar i	'''
Alfred Karamuço	Anëtar i	'''

me sekretare Arta Palushi më datë 8.9.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39 që i përket:

KËRKUES: Jani Ciko, përfaqësuar nga avokat Ali Zanko

SUBJEKTI I INTERESUAR: Kontrolli i Lartë i Shtetit, përfaqësuar nga Bardhok Mashaj e Elvis Cefa

Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në mungesë Sindikata e repartit të pllakave - Tiranë

OBJEKTI: Deklarimi antikushtetues i vendimit nr.6019, datë 29.11.1994 i Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.167, datë 18.1.1995 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.928, datë 4.7.1996 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit”, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Procesi gjyqësor për pavlefshmërinë e kontratës së shitjes është inicuar nga Shërbimi i Kontrollit të Shtetit, i cili nuk legjitimohej.

2. Padia e Shërbimit të Kontrollit të Shteti mbështetej mbi një udhëzim pa numër e datë, i cili ishte antikushtetues etj.

3. Në shqyrtimin e çështjes gjyqtarët nuk janë bazuar në ligj, por në një vendim të Këshillit të Ministrave, që vjen në kundërshtim me ligjin.

4. Gjykatat kanë bërë interpretimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave në kundërshtim me sa ka sqaruar organi administrativ kompetent, Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuarit dhe të përfaqësuesit të tij si dhe të subjekteve të interesuara;

VËREN:

Vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor duke u shkelur neni 38 i Ligjit Kushtetues “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, e për pasojë ato duhet të shpallen antikushtetuese.

Procesi gjyqësor për të shpallur të pavlefshme kontratën e shitjes së Repartit të Pllakave në Ndërmarrjen e Prodhimit të Pllakave Shtresë Tiranë, në kuadrin e privatizimit, është inicuar nga kërkesë-padia nr.35/1, datë 23.3.1994 e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit (Drejtoria e Tiranës). Në bazë të dispozitave ligjore të asaj kohe, Shërbimi i Kontrollit të Shtetit nuk ka pasur të drejtë të ngrejë padi në gjykatë për probleme të privatizimit. Në bazë të ligjit nr.7597, datë 31.8.1992 “Për shërbimin e Kontrollit të Shtetit”, ky organ ka pasur të drejtë vetëm të kontrollojë problemet e privatizimit të pronës shtetërore, por kurrësi jo të ngrejë padi në gjykatë për këto raste. Vetëm me Dekretin nr.7949, datë 14.6.1995, i cili hyri në fuqi më 2.8.1995 Shërbimit të Kontrollit të Shtetit i është dhënë e drejta të ngrejë padi në gjykatë për problemet e privatizimit dhe kthimit të pronave ish-pronarëve.

Në këto kushte pranimi për shqyrtimin gjyqësor i një padie nga një subjekt që nuk legjitimohej si dhe zhvillimi i gjykimit në të tri shkallët mbi këtë bazë, duke e pranuar si paditës këtë subjekt, i bën këto procese të parregullta në kuptimin kushtetues e për rrjedhim edhe vendimet përkatëse antikushtetuese.

Veç sa sipër, Gjykata Kushtetuese nuk mund të mos vërë në dukje edhe shkelje të tjera me karakter kushtetues të vërtetuara gjatë shqyrtimit të çështjes në të tri shkallët e gjykimit, e lidhur kjo

edhe me pretendimet që kërkuesi ngriti para kësaj Gjykate.

Qysh në gjykimin në shkallë të parë, përfaqësuesi i kërkuesit ka ngritur si prapësim faktin se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.05.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme” ku bazohej kërkesë-padia, vinte në kundërshtim me Ligjin nr.7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”. Gjykata nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të të paditurit e për pasojë në vendimin përkatës nuk i ka dhënë përgjigje. Ndodhur para një pretendimi të tillë, Gjykata Kushtetuese e pa me vend ta shqyrtonte atë nga ku rezultoi se paligjshmëria e vendimit të lartpërmendur ka qenë evidente e veçanërisht në pikat 2 e 22 të tij.

Vendimi nr.248, datë 27.05.1993 që ishte në fuqi në atë kohë, në pikën 2 caktonte si formë të vetme të privatizimit ankandin, ndërsa autorizonte “bordet” të bënë përjashtime. Por në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.7512, datë 10.08.1991 organi kompetent që shpallte formën e privatizimit caktonte kohën, radhën dhe jepte autorizimet përkatëse ka qenë Agjencia Kombëtare. Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë akte në bazë e për zbatim të ligjeve, por pa prekur ato raporte që ligji i rregullon konkretisht e për pasojë ai nuk mund të delegojë për vetë kompetencën që ligji i ka caktuar një organi tjetër. Veç kësaj, Këshilli i Ministrave nuk mund të kufizojë zbatimin e normave të ligjit siç ka ndodhur në rastin në fjalë ku privatizimi, sipas vendimit, kufizohej në formë vetëm me ankandin (me disa përjashtime për subjekte të caktuara) në një kohë që ligji lejonte një sërë formash të privatizimit veç ankandit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 në pikën 22 parashikon që procedurat për shitjen me ankand nëpërmjet bordeve etj., do të zbatoheshin edhe për ndërmarrjet që ishin në proces shitje.

Me fjalë të tjera, për rastin e kërkuesit, i cili mbi bazën e vendimit nr.177, datë 16.4.1993 të Ministrave të Ndërtimit dhe atij të Financave dhe Ekonomisë ishte pajisur me autorizimin përkatës nga Agjencia Kombëtare e për më tepër kishte paguar edhe një pjesë të vlerës së objektit, do të thoshte që të gjitha këto veprime të anuloheshin e privatizimi të fillonte nga e para nëpërmjet “bordeve”.

Dhënia në këtë mënyrë e fuqisë prapavepruese këtij vendimi vinte në kundërshtim të hapur me frymën e përmbajtjen e dispozitave kushtetuese. Në radhë të parë sepse cenohen (apo mohohen) të drejta të fituara në rrugë ligjore dhe se dyti shfuqizohen “de facto” akte të ministrave e të institucioneve të tjera, ç’ka përbënte shkelje të nenit 37 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Në kushtet kur kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr.248, datë 27.5.1993 (që i janë referuar të tria gjykatat), vjen në kundërshtim me ligjin, se, ashtu siç u analizua më lart, kundërligjshmëria e antikushtetutshmëria e këtij vendimi kanë qenë evidente, ka qenë detyra e gjykatave që pavlefshmëria e kontratës së shitjes, në zbatim të nenit 8 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 dhe të neni 17 të Kodit Civil ta shqyrtonin në radhë të parë në raport me ligjin bazë dhe nëse do të konkludonin për papajtueshmëri të Vendimit të Këshillit të Ministrave me këtë ligj, duhej të pezullonin çështjen e t’ia kalonin për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

Ashtu si mungesa e legjitimitetit edhe injorimi i këtyre kërkesave kushtetuese, dhënia përparësi absolute aktit nënligjor pa iu drejtuar ligjit bazë, i bën këto procese gjyqësore të parregullta, vendimet përkatëse antikushtetues e për rrjedhim pa efekte juridike (në kuptim të nenit 45 të Ligjit nr.8373, datë 16.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Të shpallë të papajtueshëm me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" vendimin nr.6019, datë 29.11.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.167, datë 18.1.1995 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.928, datë 4.7.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.